

I nderuar z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës tuaj protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme nr.80prot., Dt.02.02.2021 përmes të cilës kërkonti informacion mbi mesataren e kohëzgjatjes së fazës hetimore nga momenti i regjistrimit të çështjes deri në dorëzimin e kërkesës për gjykim ose pushimin e çështjes dhe mesataren e kohëzgjatjes së fazës hetimore nga momenti i kallëzimit deri në dorëzimin e kërkesës së gjykimit, pushimit të çështjes, ju informojmë se:

Nga momenti i regjistrimit të një kallëzimi penal, prokurori i caktuar me short për trajtimin e tij, ka afat 15 ditë për të vendosur për regjistrimin e tij. Në rast të kundërt duhet të procedojë me vendim mosfillimi, në referencë të nenin 291 të Kodit të Pr.Penale “Vendimi për mosfillimin e procedimit” pika 1 saktëson se “*Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit , prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij, brenda 15 ditëve nga rregjistrimi i kallëzimit.*”

Në lidhje me “Afatet e përfundimit të hetimeve”, Kreu VII i Kodit të Pr.Penale, neni 323, pika 2 saktëson se “*Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në rregjistrin e njoftimit të veprave penale ...*”. Neni 324 saktëson se “*Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në 3 muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në 6 muaj. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se 3 muaj , mund të bëhet nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse.....Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund t’i kalojë dy vjet. Tej afatit 2-vjeçar, ... afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm...*”

Duke ju falënderuar,

Koordinatori për Të Drejtën e Informimit